

**PROCES VERBAL - Tipi i kontratës – PUNË
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky proces verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: ‘Rehabilitimi i rreshqitjes ne tubacionin kryesor te furnizimit me uje ne zonen Poliçan-Berat

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj; 8 muaj e 20 dite

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
85312500-4 - Shërbime të rehabilitimit, 45262300-4 - Punime betoni, 45232150-8 - Punime të lidhura me tubacione për shpërndarëse të ujit, 45232121-6 - Punime ndërtimi për tubacione ujitje, 45232100-3 - Punimet ndihmëse për tubacionet e ujit, 45231110-9 - Punime ndërtimi për shtrim tubacionesh, 45231100-6 - Punime të përgjithshme për tubacione, 44162500-8 - Tubacione të ujit të pijshëm.

VLERA E FONDIT LIMIT: 148,495,176 (njqind e dyzet e tete milion e katerqind e nentedhjete e pese mije e njqind e shtatedhjete e gjashte) lek pa tvsh.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga **Buxheti i Shtetit.**

Autoriteti kontraktor në kriteret e përgjedhjes së fituesit ka përgjedhur si më poshtë:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

Çmimi ☐

pikët 50

Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit ☐ ☐

pikët 20

Stafi / Organizimi i Kompanise ☐ ☐

pikët 15

Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social □□ **pikët 10**

Periodha e garancisë së objektit □□ **pikët 5**

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1, 2.a, 5) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.b , 3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Çmimi [50] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit [20 pikë]

Operatori ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori duhet të argumentojë (në mënyrë përshkimore dhe grafike) kohën e propozuar (**jo më shumë se 8 muaj e 20 dite**). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nënkriteri:

a. Koha e realizimit të punimeve të kontratës që përfshin: [15 pikë]

I Kohën e mobilizimit në kantier (jo me shume se 1 muaj) [2 pike].

II Grafiku i punimeve te Kontratës. [13 Pike]

*Shënim: Operatori ekonomik për të justifikuar propozimin e këtij nënkriteri duhet të paraqesë minimalisht analizen e makinerive që do angazhojë operatori ekonomik për secilin proces dhe numrin e përafërt të punonjësve të angazhuar për çdo proces.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2a} = V_{mink2a} \times P_{maxk2a} / O_{k2a}$$

P_{k2a} Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink2a} Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

P_{maxk2a} Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2a} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

- b. Faktorë favorizues / pajisje inovative / metodologji punimesh që favorizojnë kohën e realizimit të punimeve [0-5 pikë]

3. Staf / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin 2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushen specifike [13 pikë]

***Shënim:** Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve më poshte:

I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të vecanta të kualifikimit për stafin [1 pikë]

II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e vecanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e vecanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. [6 pikë]

Për përmbushjen e kritereve të mesiperme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të leshuar nga punëdhënes të mëparshëm ose përfituesit.

- b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0 - 2 pikë]

***Shënim:** Për përmbushjen e kriterit të mesipërme operatori ekonomik duhet të dorëzojë organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologji të nderveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikëqyresin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh përbejnë sistemet e brendshme të kontrollit dhe menaxhimit të cilësise.

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efçente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0-5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [0-5 pikë]

5. Periudha e garancisë së objektit [0 – 5 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Periudha e garancisë e punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0 - 5 pikë]

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k5}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Argumentim:

Autoritetet Ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në barze çmimit ose kotos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, ne përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilesi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës procedurë prokurimi, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshihen:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë. projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij:

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit, Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bejnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve, ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë substancës së tyre thelbësore.

5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i i, çdo kriteri të zgjedhur për të percaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të raste kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Njësia e Prokurimit hartoj kërkesën për Grafikun e punimeve dhe kohën e mobilizimit dhe ka kërkuar këte kriter 20 pikë, duke vlerësuar rëndësinë që ka ky element në përfundimin e plotë dhe realizimin sukses të çdo veprë, pasi duke ndërthurur elementin cilësi, saktësi dhe precizion në kryerjen e punimeve por edhe angazhimin realisht të të gjithë stafit, inxhinierë, teknikë, specialistë, punëtorë të thjeshtë etj, mund të arrihet që punimet të kryhen edhe më shpejt se koha e planifikuar nga autoriteti kontraktor dhe njëherësh me cilësinë e duhur, duke i dhënë besimin këtij autoriteti për angazhimin serioz dhe të operatorit ekonomik pjesëmarrës cili në përfundim do të siellë rezultatet e kërkuara dhe të pritura nga autoriteti.

Operatori Ekonomik mund të propozojë duke paragitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori Ekonomik ofertues duhet të argumentoj në mënyrë përshkimore kohën e propozuar të kryerjes së punimeve.

Po kështu një rëndësi e vecantë nga autoriteti kontraktor i jepet edhe elementit Stafit/ Organizimi Kompanise, i cili vlerësohet deri në 15 pike, duke ditur që vetm një staf kualifikuar profesional inxhiniero - teknik dhe me pervoiën e duhur mund të sielle rezultatet e dëshiruara dhe të pritura nga autoriteti, kontraktor për përfundimin me sukses të objektit të prokurimit. Një operator ekonomik cili ka një staf të tillë mund të konkurrojë me cilesi pranë autoritetit kontraktor dhe të përmbushë të gjithë detyrat e projekt preventivit të parashikuar nga autoriteti kontraktor. Operatori Ekonomik ofertues duhet të deshmojë se do të angazhojë në kontratë një staf me përvojë eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit.

Disa nga nënkriteret janë formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushën specifike të cili provohet me dokumentacionin përkatës Gjithashtu operatori ekonomik duhet të paragesë edhe skemën e organizimit të stafit të propozuar për realizimin e kontratës, organigramen e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjinë e ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor etj.

Në lidhje me Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, autoriteti kontraktor ka kërkuar deri në 10 pikë, duke ditur rëndësinë që ka mjedisi aktualisht dhe fakti që në veprimet apo mosveprimet tona ndikojnë në mjedis dhe në komunitetin tonë të përbashkët pozitivisht/ negativisht

Duke patur parasysh se përvec realizimit të veprës duhet që të aplikohet nga operatorët realizues të punimeve edhe parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit. Duke ditur që nga punimet që do të kryhen gjatë ndërtimit të një veprë mund të krijohen mbetje inerte, detyrat kryesore që do të ketë parasysh operatori ekonomik janë ndër të tjera edhe kontrolli i vazhdueshëm i gjendjes së mjedisit në territorin ku do të zhvillohet aktiviteti, mbajtja pastër e gjithë territorit ku kryhet veprimtaria, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në mjedis, flore dhe faune, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar

ndikimin në popullsi, shëndetin human, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në klimë, ajër, ujë, tokë etj. Në veçanti duhet të kushtojë rëndësi edhe faktorëve: Respektimi i procedurave, normave, standarteve dhe planifikimet e paragjitura në projekt gjatë realizimit të tij si dhe të kontrollojnë vazhdimisht ecurinë e treguesve mjedisorë.

Per të gjitha këto elementë operatori ekonomik pjesëmarrës bën një pasqyrë të qartë dhe të detajuar që në momentin kur ai konkuron në procedurën e prokurimit duke dhënë Propozime konkrete se si do të ndikojë në uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, dhe më pas autoriteti kontraktor bën vlerësimin real me pikëzim të cdo operatori ekonomik ofertues.

Nenkriteret për operatoret ekonomike pjesëmarrës në këtë rast dhe që do të vlerësohen në mënyrë të pikëzuar nga Komisioni Vlerësimit të Ofertave të Autoritetit Kontraktor, do të jenë:

Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (migësore me miedisin të ricikluara/ eficiente/materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike, Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciativë sociale e ofertuesit nëpërmjet punësimeve.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024).

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar t'i zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryejë. Referuar në nenin 45 të VKM Nr. 285/2021 (i ndryshuar), kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur, e cila nuk përmend afatin e përcaktuar, do të vlerësohet minimalisht për një periudhë 2 (dy) vjeçare. Çdo ofertues, i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh, për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet me formulën e paraqitur në nënkriteret e mësipërme.

Një rëndësi e vecantë i është dhënë edhe Periudhës së garancisë së objektit e cila tregon jetegjatësinë e objektit, faktin se sa me maksimale të jetë periudha aë perfshin garancina e veprës e deklaruar nga operatori ekonomik pjesëmarrës, aq me tepër autoriteti kontraktor bindet për angazhimin, seriozitetin dhe kapacitetin e këtij operatori ekonomik, me qëllimin final realizimin përfundimtar të veprës dhe marrjen në dorëzim të saj.

Autoriteti Kontraktor ndalon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera si më poshtë:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:

- Kapaciteti ekonomik dhe financiar Kriteve të veçanta të kualifikimit, Pika 2.2.1, 2.2.2, 2.2.3, Shtojca 7 e DST-së.
- Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit teknik të Kriteve të veçanta të Kualifikimit ;
- Licenca e kërkuara sipas pikës 2.3.2/a, 2.3.2 b), 2.3.2 c) , të kapacitetit Teknik të Kriteve të veçanta të Kualifikimit.
- Staf i Teknik i kërkuar sipas pikës 2.3.3/a, 2.3.3/b, 2.3.3/c, 2.3.3/d, të Kapacitetit Teknik të Kriteve të veçanta të Kualifikimit.

Argumentimi ligjor: Në mbështetje të Nenit 84, pikat 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Nenit 90, pikat 5 dhe 6 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Autoriteti kontraktor ka vlerësuar se kapacitetet teknike dhe profesionale që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e punimeve kryesore nuk mund të transferohen tërësisht tek subjekte të treta, pasi kjo do të cenonte qëllimin e verifikimit të aftësisë reale të operatorit ekonomik që paraqet ofertën.

Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera është lejuar vetëm në masën që këto subjekte të marrin përsipër realisht realizimin e pjesës përkatëse të punimeve dhe të disponojnë licencat, personelin, pajisjet dhe eksperiencën që lidhet me zërat konkretë të preventivit që do të ekzekutojnë. Për këtë arsye është kërkuar që secili subjekt mbështetës ose anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë të disponojë licencat përkatëse në raport me punimet që merr përsipër sipas kontratës së bashkëpunimit dhe ndarjes së punimeve.

Ky kufizim mbështetet në faktin se:

- Licencat e ndërtimit përbëjnë autorizime profesionale të lidhura me aftësinë konkrete të subjektit për të realizuar kategori të caktuara punimesh dhe nuk mund të përdoren formalisht nga një operator që nuk disponon kapacitetet minimale për ekzekutimin e kontratës.
- Drejtuesit teknikë, stafi inxhinierik dhe specialistët e kërkuar janë të lidhur drejtpërdrejt me realizimin e punimeve të objektit dhe me mbikëqyrjen teknike të tyre gjatë gjithë periudhës së zbatimit. - Pajisjet dhe materialet teknologjike të kërkuara në projekt kërkojnë njohuri të specializuara instalimi dhe përgjegjësi profesionale që nuk mund të garantohen nëse operatori ofertues nuk disponon vetë kapacitetet bazë teknike për realizimin e kontratës.

Për rrjedhojë, kufizimi i mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera është vendosur për të garantuar që operatorit ekonomik ofertues të zotërojë vetë kapacitetet kryesore dhe thelbësore për realizimin e kontratës, ndërsa mbështetja nga subjektet e tjera të shërbejë vetëm si kapacitet plotësues dhe jo si zëvendësim i plotë i aftësisë teknike dhe profesionale të operatorit ofertues.

Gjithashtu, në bazë të Nenit 21 pika 2 të Ligjit N.162 / 2020 Per Prokurimin Publik, të ndryshuar, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2 të VKM Nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, njësia e prokurimit pranë Autoritetit Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizimeve, Berat Sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe

miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas përcaktimeve në Kriteret e Përgjithshme të Perzgjedhjes / Kualifikimit pika 1 e Shtojcës 7

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në kërkesat e pikes 1, Shtojca 7

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit **2023, 2024, 2025** të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë sipas nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit **2023, 2024, 2025** lëshuar nga Administrata Tatimore, ku xhiro mesatare e këtyre tre viteve të jetë me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vertetim nga organet e pushtetit lokal (Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar (**të vitit 2026**) sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” te ndryshuar, ku përcaktohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) **gjendjen ekonomike dhe financiare;** ...3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, **paragrafi 1 dhe 2 germa “b”**, parashikohet: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare¹. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Ligjit Nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton: “Çdo tatimpagues përgatit **deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme** në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, **duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël**, së bashku me anekset e tij, si dhe

çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji; Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Pika 3.12 e tij, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25 datë 10.05.2018 "Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 9 ku parashikohet: "Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përfundimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financat"; Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në keto kushte, vleresojmë të kërkojmë kete dokumentacion pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe akt ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Njësia e prokurimit kerkoi edhe **pagesat e taksave vendore** bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"(te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore si dhe faktit se në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të rregjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë Kontratën e Sipërmarrjes; formular vlerësimi lëshuar nga Investitori sipas Shtojces 9;situation perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve;Faturat Tatimore

të deklaruara në organet tatimore; Aktin e Kolaudimi; dhe Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përhershëm .

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vertetime të shoqëruara me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar).

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të

kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës. Përvojat e mëparshme janë element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Kriteri i kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedure kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë. Përdorimi i operatorëve me përvojë të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje. Përvoja e mëparshme në projekte të ngjashme siguron që operatorët janë të gatshëm për situata të papritura dhe janë në gjendje të menaxhojnë situatat e mundshme në mënyrën e duhur. Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedure.

Referuar këtij neni, njësia e prokurimit vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentave ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit”(i ndryshuar), si dhe akteve dhe VKM te dala në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin dhe situacionet përfundimtare si dhe formular vlerësimi për punët e kryera me entet publike. Kjo bëhet me qëllim që autoriteti kontraktor të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Meqënëse paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit të përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, sipas parashikimeve të nenit 88 të VKM Nr. 285

datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni autoriteti kontraktor ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që Autoriteti Kontraktor të përlllogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1.

Duke qënë se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që A.K., të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkitimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Kriteret e mëposhtme teknike nga pika 2.3.2 dhe ne fund janë propozuar dhe vendosur nga specialisti i fushës, pjesë e njësisë së prokurimit, sipas përcaktimit të nenit 74, dhe 78 të VKM nr. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik si dhe njoftimit nr. 4916/2 prot, datë 14.07.2022, pika 1, të Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi organizmin e Procedurave të Prokurimit Publik”

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

- a) Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë kriter, duhet të paraqesë liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin e Rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve Juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë profesionale të shoqërisë, të vlefshme, për kategoritë e mëposhtme:

- | | |
|---|----------------------|
| • Kategoria NP- 1 Punime gjurmimi në tokë | Klasifikimi A |
| • Kategoria NP-5 Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti | Klasifikimi A |
| • Kategoria NP- 7 Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje | Klasifikimi C |
| • Kategoria NP-8 Struktura betonarme dhe metalike | Klasifikimi B |
| • Kategoria NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit | Klasifikimi A |
| • Kategoria NS-9 Punime strukturore speciale | Klasifikimi B |
| • Kategoria NS-18 Punime topogjeodezike | Klasifikimi A |

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t’i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehsimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s'kualifikues.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **afhtësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”.*

*Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” përcaktohet “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) **licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”*

VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4). Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (të ndryshuar), si dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në liçensën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlllojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës. Llojet e licencave dhe niveli i klasifikimit të tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt. Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategoritë respektive është kërkuar bazuar në zërat e punimeve që parashikohen të kryhen dhe që përfshihen në kategorinë përkatëse brenda vlerave të kufijve të parashikuara në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar.

Sipas VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar, përcaktohet:

Në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 39 dhe nenin 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, si dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit”, kërkesa për disponimin e kategorive të licencës së mëposhtme është vendosur duke u bazuar në natyrën,

vëllimin, kompleksitetin teknik dhe zërat konkretë të preventivit të objektit “**Rehabilitimi i rrëshqitjes ne tubacionin kryesor te furnizimit me uje ne zonen Poliçan-Berat**”.

Kategoria NP-1 – Punime gjurmimi në tokë (Klasifikimi A)

Kjo kategori licence është e domosdoshme pasi preventivi përmban zëra të konsiderueshëm që lidhen me: Gjurmime për hapjen e platformave të punës; Gjurmime për realizimin e pilotave Ø800 mm; Gjurmime për drenazhime dhe kanale kullimi ; Transport dhe largim i materialeve të dala nga gjurmimi.

Punimet e gjurmimit përbëjnë fazën fillestare dhe bazë të realizimit të objektit. Pa realizimin e tyre nuk mund të kryhen punimet e pilotimit, drenazhimit apo strukturat mbajtëse. Për këtë arsye, kërkesa për kategorinë NP-1 lidhet drejtpërdrejt me zërat kryesorë të preventivit dhe është në përputhje me përcaktimet e VKM nr.42/2008.

Sipas VKM Nr.42 të datës 16.01.2008, të ndryshuar për punime në vlerën 0 deri 20 milionë lekë, nevojitet niveli “A”

Kategoria NP-5 – Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti (Klasifikimi A)

Kjo kategori përfaqëson një nga licencat kryesore të kërkuara për këtë objekt.

Preventivi përmban: Shpime me diametër Ø800 mm; Pilota të betonit të armuar; Trarë lidhës; Struktura mbajtëse për stabilizimin e rrëshqitjes; Elemente të veprave të artit dhe strukturave speciale.

Pilota Ø800 mm përbëjnë elementët kryesorë mbajtës të sistemit të stabilizimit të rrëshqitjes dhe klasifikohen si vepra arti dhe punime speciale sipas VKM nr.42/2008.

Kategoria NP-5 është e lidhur drejtpërdrejt me zërat e preventivit ,sipas VKM Nr.42 të datës 16.01.2008, të ndryshuar për punime në vlerën 0 deri 20 milionë lekë, nevojitet niveli “A”

Kategoria NP-7 – Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi dhe vaditje (Klasifikimi C)

Zëri kryesor që ka dhe peshën më të madhe financiare në preventive është tubacioni DN 700 DCI ,gjithashtu një nga shkaqet kryesore të aktivizimit të rrëshqitjeve të terrenit është infiltrimi dhe prania e ujërave nëntokësore.

Preventivi parashikon: Furnizim dhe vendosje të tubacionit DN700; Drenazhime horizontale; Drenazhime vertikale; Kanale kullimi; Largim të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Të gjitha këto punime përfshihen drejtpërdrejt në kategorinë NP-7.

Klasifikimi C është kërkuar bazuar nga vlera e konsiderueshme e zërave të drenazhimit dhe tubacionit DN700 në raport me vlerën e përgjithshme të kontratës. Përcaktimi i nivelit “C” të kësaj kategorie është bërë në bazë , të VKM në fjalë, sipas të cilës, për punime në vlerën 51 deri 100 milionë lekë, nevojitet niveli “C”

Kategoria NP-8 – Struktura betonarme dhe metalike (Klasifikimi B)

Preventivi përmban: Beton C25/30; Armaturë çeliku; Pilota betonarme; Trarë betonarme; Elementë konstruktivë mbajtës; Elemente metalike ndihmëse.

Realizimi i këtyre punimeve kërkon operator ekonomik me eksperiencë dhe licencë për ndërtimin e strukturave betonarme.

Për shkak se sistemi i stabilizimit bazohet kryesisht në pilota dhe trarë betonarme.

Përcaktimi i nivelit “B” të kësaj kategorie është bërë në bazë të Lidhjes 4, të VKM në fjalë, sipas të cilës, për punime në vlerën 21 deri 50 milionë lekë, nevojitet niveli “B”.

Kategoria NP-12 – Punime të inxhinierisë së mjedisit (Klasifikimi A)

Preventivi përfshin: Largimin e materialeve të gërmimit; Menaxhimin e mbetjeve inerte; Sistemin e skarpatave; Rehabilitimin përfundimtar të terrenit; Punime për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit.

Punimet kryhen në një zonë të prekur nga fenomenet gjeologjike dhe synojnë rikthimin e stabilitetit të terrenit, duke minimizuar ndikimin mjedisor, sipas VKM Nr.42 të datës 16.01.2008, të ndryshuar për punime në vlerën 0 deri 20 milionë lekë, nevojitet niveli “A”

Kategoria NS-9 – Punime strukturore speciale (Klasifikimi B)

Kjo kategori lidhet drejtpërdrejt me: Pilota të thella Ø800 mm; Punime gjeoteknike; Struktura mbajtëse kundër rrëshqitjes; Elemente speciale të stabilizimit.

Punimet nuk përbëjnë ndërtim të zakonshëm civil, por ndërhyrje të specializuara gjeoteknike dhe strukturore. Përcaktimi i nivelit “B” të kësaj kategorie është bërë në bazë të Lidhjes 4, të VKM në fjalë, sipas të cilës, për punime në vlerën 21 deri 50 milionë lekë, nevojitet niveli “B”.

Kategoria NS-18 – Punime topogjeodezike (Klasifikimi A)

Preventivi dhe natyra e objektit kërkojnë: Piketimin e pilotave; Piketimin e drenazhimeve; Piketimin e tubacionit DN700; Kontrollin e koordinatave dhe kuotave; Matjen e volumeve të gërmimeve; Hartimin e situacioneve mujore; Monitorimin e lëvizjeve të terrenit gjatë zbatimit.

Për shkak të rëndësisë së kontrollit topografik në realizimin e saktë të pilotave dhe sistemit të drenazhimit, disponimi i licencës NS-18 është i domosdoshëm. sipas VKM Nr.42 të datës 16.01.2008, të ndryshuar për punime në vlerën 0 deri 20 milionë lekë, nevojitet niveli “A”

b) Çertifikatat që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomikë:

- Certifikatë ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilesisë”, objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikatë ISO 14001-2015 ose 14001: 2026 “Për Sistemin e menaxhimit të mjedisit”, objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

- Certifikatë ISO 45001-2018 “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, ose certifikatë me standartin e përditësuar Certifikatë ISO 45001-2023, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikatë SSH/DIN/EN/UNI ISO 3834-2:2021, (Sistemi i Menaxhimit të Cilesise ne Saldim), e vlefshme, ose ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontrates së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”¹ në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata** të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standardet e menaxhimit të mjedisit. Në bazë të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme. Referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për të vërtetuar se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret si më lart duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës, por edhe sepse ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin e besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Çertifikatë ISO 9001 - 2015 “Per Sistemin e menaxhimit te cilesise”, mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi si dhe mundeson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj. Kjo kërkesë shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që operatori ekonomik ofertues është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë.

Çertifikatë ISO 14001-2015 “Per sistemin e menaxhimit te mjedisit” kërkohej pasi angazhimi për mbrojtjen e mjedisit ishte një kriter madhor në zgjedhjen e një prodhuesi, kurse metoda me efikasë për të shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin ishte zbatimi i një sistemi menaxhimi për mjedisin konform me parashikimet e standartit ndërkombëtar ISO 14001. Kërkesa lidhur me çertifikimin ISO 14001:2015 ose certifikatë me standartin e përditësuar ISO 14001:2026, bëhet pasi zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kontratës. Të gjitha punimet e parashikuara në vepër duhen kryer në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të përgatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu kjo certifikatë është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik për marrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar atë sa lejon sistemi, ku gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis, si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra, ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

- **Certifikatë ISO 45001-2018** “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, ose certifikatë me standartin e përditësuar **Certifikatë ISO 45001-2023** mundeson që çdo shoqëri të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, dhe përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve, hetimin e incidenteve etj. Kjo kërkesë është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit që lidhet me procese pune ndërtimi. Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta e për këtë arsye, Autoriteti kontraktor duhet të sigurohet se Operatorët ofertues zotërojnë kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin e risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës. Pajisja me këtë lloj certifikate dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës. Çertifikatë ISO 45001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik në lidhje me vlerësimin e rreziqut dhe përgatitjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/ eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor, ku veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Bazuar në preventivin e objektit “Projekti i detajuar për zonën e rrëshqitjes afër Polican, linja kryesore DN700 për furnizimin me ujë të qytetit të Beratit”, kërkesa për Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI ISO 3834-2:2021 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë në Saldim) është e

argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, pasi objekti përfshin furnizimin dhe montimin e elementeve metalike dhe të tubacioneve që kërkojnë procese saldimi me kërkesa të larta cilësie.

Në preventiv janë parashikuar veçanërisht këto zëra: An2 – F.V Tubi DN 700 mm, në sasinë 500 ml; An3 – F.V Xhunto deformimi trau; An4 – F.V Xhunto deformimi tubi; An5 – F.V Mbështetëset e traut; An6 – F.V Mbështetëset e tubit; An7 – F.V Kapëse çeliku.

Këto elemente përbëhen nga komponentë metalikë dhe konstruksione mbajtëse të cilat gjatë prodhimit, fabrikimit, montimit ose instalimit kërkojnë procese saldimi të kontrolluara. Cilësia e saldimeve ndikon drejtpërdrejt në: qëndrueshmërinë strukturore të mbështetëseve dhe kapëseve të çelikut; sigurinë e linjës kryesore të ujës-jellësit DN700; rezistencën ndaj ngarkesave statike dhe dinamike; shmangien e defekteve, deformimeve dhe rrjedhjeve në sistemin e furnizimit me ujë.

ISO 3834-2:2021 përcakton kërkesat e plota të cilësisë për saldimin me shkrirje të materialeve metalike dhe garanton që operatori ekonomik disponon: procedura të kualifikuara saldimi (WPS); personel saldimi të kualifikuar; kontroll dhe gjurmueshmëri të proceseve të saldimi; inspektim dhe verifikim të cilësisë së saldimeve; dokumentim teknik sipas standardeve ndërkombëtare.

c) Në përputhje me kërkesat, specifikimet teknike dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- ✓ **Tubacion Gize** (Duktile DIN EN 545, K9)
- ✓ **Rakorderi**

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj (pervecese gjuhes angleze), ky dokument mund të paraqitet në gjuhën zyrtare shqipe ose angleze.
- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.
- Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë **çertifikatë / vetëdeklarim nga Prodhuesi** që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shënim: Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtori.

Argumentimi: Bazuar në preventivin e ngarkuar për objektin “Projekti i detajuar për zonën e rrëshqitjes afër Policanit në linjën kryesore DN700 për furnizimin me ujë të qytetit të Beratit”, kërkesa për paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit, katalogëve teknikë dhe certifikimit ISO 9001:2015 për Tubacionin e Gizës DN700 (Duktile DIN EN 545, K9, shtresa zinku jashtë min 200g/m² dhe shtytje përmbajtëse në nyje, duke përfshirë guarnicionet e nevojshme dhe materialin frenues për nyjet brenda sipas EN 545. dn 700) dhe rakorderitë përkatëse është plotësisht e justifikuar dhe në përputhje me natyrën e punimeve të parashikuara në preventiv.

Në preventiv, tek zëri An2 – F.V. Tubi DN 700 mm, janë parashikuar: 500 ml tubacion gize DN700, me vlerë të konsiderueshme ekonomike prej 52,244,960.20 lekë. Gjithashtu janë parashikuar elementë ndihmës të sistemit, si: Xhunto deformimi trau; Xhunto deformimi tubi; Mbështetëse të traut; Mbështetëse të tubit; Kapëse çeliku.

Këto elemente përbëjnë një sistem unik dhe të integruar të linjës kryesore të ujësjellësit DN700, ku përputhshmëria teknike ndërmjet tubacionit dhe rakorderive është kusht thelbësor për garantimin e funksionimit, jetëgjatësisë dhe sigurisë së veprës.

Autorizimi i Prodhuesit ose Marrëveshja e Bashkëpunimit kërkohet për të garantuar se operatori ekonomik ka akses të drejtpërdrejtë dhe të ligjshëm te produktet origjinale të prodhuesit, si dhe për të siguruar furnizimin e plotë dhe të pandërprerë të tubave dhe rakorderive gjatë zbatimit të kontratës. Duke qenë se tubacioni DN700 është komponenti kryesor i investimit, Autoriteti Kontraktor duhet të ketë mundësinë të verifikojë origjinën dhe autenticitetin e materialeve.

Katalogët shërbejnë për të verifikuar: dimensionet DN700; klasën e presionit; materialin e prodhimit; tipin e nyjeve dhe rakorderive; përputhshmërinë me specifikimet teknike të projektit. Përmes katalogëve Autoriteti Kontraktor mund të konfirmojë se produktet e ofruara janë pikërisht ato të kërkuara në preventiv dhe projekt.

Duke qenë se tubacioni DN700 dhe rakorderitë përfaqësojnë pjesën më të rëndësishme të sistemit të furnizimit me ujë, kërkohet që prodhuesi të operojë sipas një sistemi të certifikuar të menaxhimit të cilësisë. ISO 9001:2015 garanton kontroll të proceseve të prodhimit, gjurmueshmëri të produktit dhe standard të qëndrueshëm cilësie, duke minimizuar rrezikun e defekteve që mund të shkaktojnë avari në linjën kryesore të ujësjellësit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:

- a) Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë punësuar minimalisht **45 (dyzet e pesë)** punonjës për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën e mesiperme në Formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesiperme.

- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesiperme.

Argumentim: Në mbështetje të nenit 77, pika 1 dhe pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si kriter kualifikimi disponimin e një numri mesatar prej jo më pak se **45 (dyzet e pesë)** punonjësish për periudhën e tre muajve të fundit nga data e hapjes së procedurës së prokurimit.

Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesën që operatori ekonomik pjesëmarrës të ketë të punësuar minimalisht **45 (dyzet e pesë)** punonjës për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit para datës së hapjes së tenderit, pasi kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me natyrën, përmasat, kompleksitetin teknik dhe volumnin e punimeve të parashikuara në preventiv.

Nga analiza e preventivit rezulton se objekti përfshin punime të konsiderueshme gërmimi, shpime gjeoteknike dhe pilotime Ø800 mm, realizim strukturash betonarme, drenazhime horizontale dhe vertikale, montim të tubacionit DN700, sistemim skarpatah dhe rehabilitim mjedisor. Këto procese nuk zhvillohen në mënyrë të izoluar, por kërkojnë organizimin dhe funksionimin paralel të disa fronteve pune gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Konkretisht, preventivi përmban: gërmime të konsiderueshme për pilotat, drenazhimet dhe tubacionet; shpime dhe realizim pilotash Ø800 mm; furnizim dhe vendosje armature çeliku; betonime për pilota dhe trarë lidhës; montim tubacioni DN700 dhe elementëve të drenazhimit; ndërtim pusetash dhe elementësh ndihmës; sistemim dhe rehabilitim të terrenit të prekur nga rrëshqitja.

Për realizimin e këtyre punimeve kërkohet angazhimi i njëkohshëm i: personelit inxhinierik dhe teknik; specialistëve të pilotimit dhe shpimeve; operatorëve të makinerive të rënda; shoferëve të mjeteve të transportit; betonuesve; hidroizoluesve; hekurkthyesve; punëtorëve të krahut; personelit të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Gjithashtu, nga lista e makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës rezulton se do të operojnë njëkohësisht ekskavatorë, fadroma, mjete transporti, pajisje shpimi, autobetoniera dhe pajisje të tjera teknologjike, të cilat kërkojnë personel të dedikuar për operimin e tyre.

Numri minimal prej **45 (dyzet e pesë)** punonjësish është përllogaritur duke marrë në konsideratë nevojën për funksionimin paralel të disa fronteve pune, organizimin e kantierit, zbatimin e punimeve sipas grafikut të realizimit dhe përmbushjen e afateve kontraktore. Ky numër përfshin si personelin teknik e specialist, ashtu edhe fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin fizik të punimeve.

Përcaktimi i këtij kriteri synon të garantojë që operatori ekonomik disponon kapacitetet reale njerëzore për të përballuar volumnin e punimeve të preventivit dhe nuk mbështetet vetëm në angazhime të përkohshme pas shpalljes së procedurës. Kërkesa për disponimin e këtij numri punonjësish për periudhën 3-mujore para datës së hapjes së tenderit shërben si provë e kapacitetit të qëndrueshëm organizativ dhe operacional të operatorit ekonomik.

b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë** të cilët të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:

- | | |
|--|---------|
| • Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |
| • Inxhinier Ndertimi, Prolfili Strukturist /Kostruktor | 1 (një) |
| • Inxhinier Gjeoteknik | 1 (një) |
| • Inxhinier Gjeodet / Topograf/ Markshajder | 1 (një) |
| • Inxhinier Gjeolog | 1 (një) |

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

1. Kontratë pune të vlefshme,
2. Diplome,
3. Listepagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, ku duhet të figurojnë stafi i mësipërm

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM – së 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar përsa i takon ndalimeve të dypunësimit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklaratimet e operatorit ekonomik në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mësipërm Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit Teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi).

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Shenim : Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për inxhinieret e mesipërm, emer/mbiemer, atesia, numrin personal të ID , numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka leshuar këtë dokument.

c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin tjetër inxhinierik** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- | | |
|----------------------|---------|
| • Inxhinier Ndërtimi | 1 (një) |
| • Inxhinier Pyjesh | 1 (një) |

Për stafin e mësipërm inxhinierik Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune, CV dhe të figurojë në Listepagesa për të paktën 3 muajt e Fundit.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

d) Operatori ekonomik pjesëmarrës, në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, duhet të përcaktojë me anë të një **deklarate** (nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë), **Drejtuesin Teknik të punimeve** (inxhinier me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërise dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

❖ Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës Nr.8 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës se zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV.

e) Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë të punësuar stafin teknik të përbërë nga punonjës të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit, duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit, me profesione si më poshtë:

- 2 (dy) teknike ndertimi
- 1 (nje) teknik topograf
- 3 (tre) hekurkthyes
- 2 (dy) hidroizolues
- 2 (dy) karpentier
- 2 (dy) saldator
- 2 (dy) punonjesh konstruksione metalike
- 2(dy) hidraulik
- 5 (pese) betonues
- 7 (shtate) punetore te thjeshte ndertimi
- 3 (tre) shofere për drejtim mjeteve të pajisur me leje drejtimi me kategorine “C” dhe/ose “CE” dhe/ose “D” dhe/ose “DE” leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike / private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për specialistët e mësipërm (me përjashtim të punonjësve shoferë dhe bojaxhi) të paraqiten kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, të lëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve.

Shënim: Për shoferët, Operatori Ekonomik pjesëmarrës mund t'i disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

f) Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të paktën:

- **4 (kater)** Manovratorë / Eskavatoristë / Automakinist, të cilët mund të jenë pjesë e stafit ose të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune / shërbimi të vlefshme; Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor; Kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme të lëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë **burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, **si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.**” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale,

kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe /ose c) **fuqinë punëtore të operatorit ekonomik** të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 39 dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, si dhe legjislacionit për zbatimin e punimeve të ndërtimit, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar disponimin e stafit inxhinierik minimal, pasi objekti përfshin punime gjeoteknike, hidroteknike, strukturore, topografike dhe mjedisore të cilat kërkojnë mbikëqyrje të specializuar gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Objekti i prokurimit përfshin punime të stabilizimit të rrëshqitjes së terrenit, realizim pilotash Ø800 mm, drenazhime, montim tubacioni DN700, struktura betonarme dhe rehabilitim mjedisor, çka e bën të domosdoshme praninë e specialistëve të profileve të ndryshme inxhinierike.

Inxhinier Hidroteknik

Kërkesa për një Inxhinier Hidroteknik lidhet drejtpërdrejt me zërat e preventivit që përfshijnë: tubacionin DN700; drenazhimet horizontale; drenazhimet vertikale; pusetat dhe veprat e kullimit; disiplinimin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Duke qenë se shkaku kryesor i aktivizimit të rrëshqitjes lidhet me praninë dhe infiltrimin e ujërave, funksionimi korrekt i sistemit të drenazhimit përbën elementin kryesor të projektit. Për këtë arsye, Inxhinieri Hidroteknik është përgjegjës për kontrollin teknik të punimeve hidraulike dhe garantimin e funksionalitetit të sistemit kullues.

Inxhinier Ndërtimi – Profil Strukturist /Konstruktore

Preventivi përmban zëra të rëndësishëm të: pilotave Ø800 mm; armaturave të çelikut; betonit strukturor; trarëve betonarme; elementeve mbajtëse të stabilizimit.

Strukturisti është specialisti përgjegjës për kontrollin e realizimit të elementeve betonarme dhe verifikimin e zbatimit të detajeve konstruktive sipas projektit.

Duke qenë se siguria e veprës varet drejtpërdrejt nga cilësia e pilotave dhe strukturave mbajtëse, kjo kërkesë konsiderohet plotësisht e justifikuar.

Kërkohet për shkak se objekti përfshin: gërmime masive; realizim pilotash; betonime; trarë lidhës; struktura mbajtëse; sisteme terreni.

Ky inxhinier është përgjegjës për organizimin e kantierit, koordinimin e proceseve të ndërtimit, kontrollin e cilësisë së punimeve dhe respektimin e projektit të zbatimit.

Për shkak të volumit dhe kompleksitetit të punimeve civile, prania e Inxhinierit të Ndërtimit është e domosdoshme gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Inxhinier Gjeoteknik, Objekti i kontratës lidhet drejtpërdrejt me stabilizimin e një rrëshqitjeje aktive.

Preventivi përfshin:shpime gjeologo-inxhinierike; pilota stabilizuese; drenazhime të masivit; ndërhyrje në terren me karakter gjeoteknik.

Inxhinieri Gjeoteknik është specialisti kryesor për interpretimin e kushteve të terrenit, kontrollin e parametrave gjeoteknikë gjatë zbatimit dhe monitorimin e sjelljes së masivit të tokës.

Për shkak të natyrës së objektit, kjo figurë profesionale është thelbësore dhe lidhet drejtpërdrejt me qëllimin e investimit.

*Kërkesa për disponimin e **1 (një) Inxhinieri Gjeoteknik** është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, si dhe me natyrën e veçantë të objektit, i cili konsiston në **stabilizimin e një zone rrëshqitjeje**, ku problematika kryesore lidhet drejtpërdrejt me sjelljen gjeoteknike të terrenit.*

Objekti nuk përbën një ndërtim të zakonshëm civil, por një ndërhyrje të specializuar gjeoteknike, ku efektiviteti i investimit varet nga interpretimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i kushteve gjeologjike dhe gjeoteknike gjatë fazës së zbatimit.

Nga analiza e preventivit rezulton se punimet kryesore përfshijnë:shpime gjeologo-inxhinierike dhe pilota me diametër Ø800 mm; germime në thellësi dhe formim platformash pune; drenazhime horizontale dhe vertikale për uljen e presioneve ujore në masivin e tokës; realizim strukturash betonarme stabilizuese; sistemim dhe modelim të skarpatave; rehabilitim të terrenit të prekur nga rrëshqitja.

Këto punime janë të lidhura ngushtë me parametrat gjeoteknikë të terrenit, si:rezistenca mekanike e shtresave të tokës; qëndrueshmëria e skarpatave; niveli i ujërave nëntokësore; deformimet dhe zhvendosjet e masivit; kapaciteti mbajtës i pilotave; kontrolli i stabilitetit gjatë fazave të gërmimit.

Në veçanti, zërat e preventivit që lidhen drejtpërdrejt me ekspertizën e Inxhinierit Gjeoteknik janë:

Pilota përbën elementin kryesor strukturor të sistemit të stabilizimit. Inxhinieri Gjeoteknik kontrollon:përputhjen e kushteve reale të terrenit me studimin gjeoteknik; thellësinë efektive të pilotimit; karakteristikat e shtresave ku ankorohet pilota; parametrat e shpimit dhe betonimit.

Shpimet gjeologo-inxhinierike, Gjatë realizimit të shpimeve mund të evidentohen kushte të ndryshme nga ato të parashikuara në projekt. Për këtë arsye kërkohet vlerësimi dhe interpretimi i vazhdueshëm nga specialisti gjeoteknik.

Drenazhimet horizontale dhe vertikale, Qëllimi kryesor i drenazhimeve është reduktimi i presionit të ujërave nëntokësore që ndikojnë në aktivizimin e rrëshqitjes. Efikasiteti i këtyre punimeve lidhet drejtpërdrejt me analizën gjeoteknike të masivit.

Gërmimet dhe sistemimi i skarpatave, Gjatë gërmimeve krijohen kushte të përkohshme të paqëndrueshmërisë së terrenit. Inxhinieri Gjeoteknik monitoron: këndet e pjerrësisë; sigurinë e skarpatave; stabilitetin e platformave të punës; masat mbrojtëse gjatë zbatimit.

Strukturat mbajtës,Elementët betonarme dhe pilotat funksionojnë si pjesë e një sistemi të integruar stabilizimi. Kontrolli i sjelljes së terrenit dhe ndërveprimit tokë-strukturë kërkon ekspertizë gjeoteknike të specializuar.

Volumi i konsiderueshëm i punimeve të gërmimit, shpimit, drenazhimit dhe pilotimit, i shoqëruar me faktin se objekti ndërhyn në një zonë me fenomen aktiv rrëshqitjeje, kërkon monitorim të

vazhdueshëm teknik gjatë gjithë periudhës së zbatimit. Ndryshe nga objektet e zakonshme të ndërtimit, ku kontrolli fokusohet kryesisht në elementët strukturorë, në këtë objekt kontrolli kryesor lidhet me sjelljen e terrenit dhe efektivitetin e masave stabilizuese.

Inxhinier Gjeodet / Topograf / Markshajder

Punimet e parashikuara në preventiv kërkojnë: pikeimin e pilotave; pikeimin e drenazhimeve; pikeimin e tubacionit DN700; kontrollin e kuotave; matjen e volumeve të gjurmimeve; hartimin e situacioneve të punimeve; kontrollin e deformimeve të terrenit.

Duke qenë se pozicionimi i saktë i pilotave dhe drenazhimeve është element kyç për funksionimin e projektit, prania e një Inxhinieri Gjeodet/Topograf është e domosdoshme.

*Konkretisht, Inxhinieri Gjeodet/Topograf lidhet drejtpërdrejt me zërat e preventivit që përfshijnë: **Gërmimet në tokë**, për të përcaktuar kufijtë e gërmimeve, kuotat e projektit dhe verifikimin e volumeve të gërmuara; **Shpimet dhe pilotat Ø800 mm**, për pikeimin e saktë të akseve dhe koordinatave të çdo pilote, pasi devijimet në pozicionim mund të ndikojnë drejtpërdrejt në funksionin stabilizues të strukturës; **Trarët lidhës dhe strukturat betonarme**, për kontrollin e pozicionimit planimetrik dhe altimetrik të elementeve konstruktivë; **Tubacionin DN700**, për gjurmimin e aksit të tubacionit, kontrollin e pjerrësive hidraulike dhe kuotave të vendosjes; **Drenazhimet horizontale dhe vertikale**, të cilat kërkojnë përcaktim të saktë të kuotave dhe drejtimeve sipas projektit; **Pusetat dhe veprat e kullimit**, për verifikimin e kuotave hyrëse dhe dalëse të rrjedhjes; **Sistemimin e skarpave**, për kontrollin e pjerrësive të projektuara dhe volumeve të sistemit; **Matjen dhe rakordimin e volumeve të punimeve**, të cilat shërbejnë për hartimin e situacioneve mujore dhe certifikimin e punimeve të realizuara.*

Për më tepër, duke qenë se objekti lidhet me një fenomen gjeologjik aktiv (rrëshqitje toke), monitorimi topografik i deformimeve dhe lëvizjeve të mundshme të terrenit gjatë fazës së zbatimit përbën një element të rëndësishëm teknik për garantimin e sigurisë së punimeve dhe të strukturave të realizuara.

*Për objektin “**Projekti i detajuar për zonën e rrëshqitjes afër Polican, linja kryesore DN700 për furnizimin me ujë të qytetit të Beratit**”, kërkesa për 1 (një) Inxhinier Gjeolog është e domosdoshme dhe lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve të parashikuara në preventiv, pasi vetë objekti ka në fokus ndërhyrjen në një **zonë aktive rrëshqitjeje** ku do të realizohen punime gërmimi, stabilizimi dhe ndërtimi i veprave mbështetëse për mbrojtjen e linjës kryesore të ujësjellësit DN700.*

Roli i Inxhinierit Gjeolog është thelbësor për: identifikimin dhe vlerësimin e kushteve gjeologjike të terrenit; analizimin e shkaqeve dhe mekanizmave të rrëshqitjes së masivit; vlerësimin e karakteristikave të shtresave të tokës dhe shkëmbit; monitorimin e stabilitetit të shpatit gjatë zbatimit të punimeve; përcaktimin e masave të nevojshme për stabilizimin e terrenit dhe mbrojtjen e infrastrukturës ekzistuese; verifikimin e kushteve të themelimit të elementeve mbështetëse dhe konstruksioneve të parashikuara në preventiv.

Inxhinieri gjeolog lidhet veçanërisht nga zërat e preventivit që lidhen me: gërmimet dhe formësimin e terrenit në zonën e rrëshqitjes; ndërtimin e strukturave mbajtëse dhe elementeve të stabilizimit; vendosjen e mbështetëseve të tubacionit DN700; realizimin e veprave që ndikojnë drejtpërdrejt në ekuilibrin gjeologjik dhe gjeoteknik të shpatit.

Në projektet e stabilizimit të rrëshqitjeve, inxhinieri gjeolog është një nga specialistët kryesorë përgjegjës për investigimin, interpretimin e kushteve të nëntokës, vlerësimin e sipërfaqeve të

rrëshqitjes, regjimit ujëmbajtës dhe monitorimin e sjelljes së masivit gjatë zbatimit të punimeve. Ai bashkëpunon me inxhinierët gjeoteknikë dhe të ndërtimit për të garantuar që masat e projektuara të stabilizimit të jenë efektive dhe të sigurt.

Argumentimi i stafit shtesë inxhinierik (jo domosdoshmërisht drejtues teknik)

Inxhinier Ndërtimi

Përveç Inxhinierit të Ndërtimit që figuron si drejtues teknik, kërkohet edhe një Inxhinier Ndërtimi shtesë për shkak të zhvillimit paralel të punimeve: gërmimeve; pilotave; betonimeve; drenazhimeve; sistemit të terrenit.

Objekti përfshin disa procese ndërtimore që realizohen njëkohësisht dhe kërkojnë koordinim të vazhdueshëm teknik. Inxhinieri shtesë mundëson kontrollin e përditshëm të punimeve në terren dhe garanton respektimin e afateve dhe standardeve të projektit.

*Për objektin “**Projekti i detajuar për zonën e rrëshqitjes afër Polican, linja kryesore DN700 për furnizimin me ujë të qytetit të Beratit**”, kërkesa për 1 (një) Inxhinier Pyjesh është e argumentuar teknikisht për shkak të natyrës së veçantë të ndërhyrjes në një zonë me rrëshqitje aktive, ku krahas masave inxhinierike të stabilizimit kërkohen edhe masa për mbrojtjen e terrenit, kontrollin e erozionit dhe rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara.*

Punimet e parashikuara në preventiv përfshijnë gërmime, ndërhyrje në shpatet e rrëshqitjes, vendosje të elementeve mbështetëse dhe stabilizim të linjës kryesore DN700. Këto ndërhyrje shkaktojnë zhveshje të sipërfaqeve të tokës dhe ndryshim të ekuilibrit natyror të terrenit, duke rritur rrezikun e erozionit dhe degradimit të mëtejshëm të shpatit. Në projekte të tilla, inxhinieri i pyjeve luan rol të rëndësishëm në projektimin dhe mbikëqyrjen e masave biologjike dhe bioinxhinierike për stabilizimin e terrenit, revegetimin e sipërfaqeve të prekura dhe mbrojtjen nga erozioni.

Konkretisht, Inxhinieri Pyjesh është i nevojshëm për: vlerësimin e mbulesës bimore ekzistuese dhe ndikimit të punimeve në të; përcaktimin e masave të rehabilitimit mjedisor pas përfundimit të punimeve; projektimin dhe monitorimin e revegetimit të shpatit me specie të përshtatshme; kontrollin e erozionit sipërfaqësor dhe stabilizimin biologjik të terrenit; monitorimin e zonave të ekspozuara ndaj rrëshqitjeve dhe shpëlarjes së tokës; koordinimin e masave bioinxhinierike me strukturat inxhinierike të stabilizimit.

Literatura teknike ndërkombëtare mbi stabilizimin e rrëshqitjeve dhe mbrojtjen e shpateve thekson se mbulesa bimore, sistemet rrënjore dhe revegetimi janë elementë të rëndësishëm për reduktimin e erozionit, rritjen e qëndrueshmërisë së shtresave sipërfaqësore dhe rehabilitimin e zonave të prekura nga punimet ndërtimore. Në shumë raste, masat biologjike kombinohen me masat strukturore për të siguruar stabilitet afatgjatë të terrenit.

Drejtuesi teknik i kantierit:

*Kërkesa që operatori ekonomik pjesëmarrës të përcaktojë me deklaratë **Drejtuesin Teknik të Punimeve**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën profesionale të shoqërisë dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, është vendosur në përputhje me: nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; nenin 39 dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021; Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”; legjislacionin për licencimin e shoqërive të ndërtimit dhe zbatimin e punimeve.*

Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me natyrën, kompleksitetin teknik dhe volumin e punimeve të parashikuara në preventiv.

Objekti i prokurimit konsiston në stabilizimin e një zone rrëshqitjeje dhe përfshin punime të specializuara gjeoteknike, hidroteknike dhe strukturore, të tilla si: gërmime në terren me karakter të paqëndrueshëm; shpime dhe realizim pilotash Ø800 mm; drenazhime horizontale dhe vertikale; montim të tubacionit DN700; realizim strukturash betonarme; sistemim dhe rehabilitim të skarpatave; mbjellje bari dhe pemësh për mbrojtjen nga erozioni.

Këto punime përbëjnë procese komplekse që kërkojnë koordinim të vazhdueshëm teknik dhe vendimmarrje profesionale në terren gjatë gjithë fazës së zbatimit.

Nga preventivi rezulton se punimet do të zhvillohen në disa fronte pune njëkohësisht, duke përfshirë: frontin e gërmimeve dhe transportit; frontin e pilotimit; frontin e drenazhimeve; frontin e betonimeve dhe armaturave; frontin e sistemimit dhe rehabilitimit të terrenit.

Për shkak të volumit të konsiderueshëm të punimeve dhe ndërveprimit të disa disiplinave inxhinierike, kërkohet një figurë profesionale e vetme përgjegjëse që të koordinojë të gjitha aktivitetet e zbatimit dhe të garantojë respektimin e projektit, specifikimeve teknike, normave të sigurisë dhe afateve kontraktore.

Roli i Drejtuesit Teknik

Drejtuesi Teknik është personi përgjegjës për: organizimin teknik të kantierit; koordinimin e stafit inxhinierik dhe teknik; kontrollin e cilësisë së punimeve; zbatimin korrekt të projektit; verifikimin e proceseve të betonimit, pilotimit dhe drenazhimit; administrimin e dokumentacionit teknik të objektit; respektimin e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë; bashkëpunimin me mbikëqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor.

Prania e tij e vazhdueshme në objekt është thelbësore për të garantuar që çdo proces pune të realizohet sipas kërkesave teknike dhe standardeve të zbatimit.

Lidhja me licencën profesionale, *Kërkesa që Drejtuesi Teknik të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë garanton që operatori ekonomik disponon kapacitetet profesionale të certifikuara dhe të njohura nga organet kompetente të licencimit. Kjo siguron që drejtimi teknik i punimeve të ushtrohet nga një specialist me kualifikimin dhe përgjegjësinë profesionale të kërkuar nga legjislacioni i ndërtimit.*

Duke qenë se objekti përfshin punime gjeoteknike, hidroteknike, strukturore dhe mjedisore me volum të konsiderueshëm dhe nivel të lartë kompleksiteti teknik, kërkesa për përcaktimin e një Drejtuesi Teknik të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të pranishëm gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve është plotësisht e justifikuar, proporcionale me objektin e kontratës dhe e nevojshme për garantimin e realizimit cilësor, të sigurt dhe brenda afateve të investimit, në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020, VKM nr. 285/2021 dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar disponimin e personelit teknik dhe specialist të mëposhtëm, pasi ky personel lidhet drejtpërdrejt me natyrën, kompleksitetin teknik dhe volumin e punimeve të parashikuara në preventiv për stabilizimin e zonës së rrëshqitjes.

Teknik Ndërtimi (2)

Kërkesa për 2 teknikë ndërtimi lidhet me faktin se punimet do të zhvillohen në disa fronte pune paralelisht, si: gërmime dhe sistemim terreni; realizim pilotash Ø800 mm; betonime dhe armatura; drenazhime dhe vendosje tubacioni DN700.

Teknikët e ndërtimit ndjekin zbatimin e përditshëm të punimeve, kontrollojnë respektimin e projektit, evidentojnë sasitë e realizuara dhe asistojnë stafin inxhinierik në organizimin e kantierit.

Teknik Topograf (1)

Kërkohet për shkak të zërave të preventivit që përfshijnë: piketimin e pilotave Ø800 mm; piketimin e drenazhimeve; piketimin e tubacionit DN700; kontrollin e kuotave të gërmimeve dhe mbushjeve; matjen e volumeve të punimeve.

Ky specialist asiston Inxhinierin Gjeodet në verifikimin e vazhdueshëm të pozicioneve dhe kuotave sipas projektit.

Hekurkthyes (3)

Kërkesa lidhet drejtpërdrejt me zërat e preventivit që përfshijnë: furnizim dhe vendosje armature çeliku; realizim pilotash betonarme Ø800 mm; trarë betonarme; elemente të tjera konstruktive të armuara.

Hekurkthyesi është përgjegjës për prerjen, përpunimin, lidhjen dhe montimin e armaturës sipas detajeve konstruktive të projektit.

Hidroizolues (2)

Kërkohen për realizimin e punimeve që lidhen me: drenazhimet; mbrojtjen e elementeve të betonit nga depërtimi i ujit; izolimin e elementeve që janë në kontakt të vazhdueshëm me lagështinë dhe ujërat nëntokësore.

Duke qenë se objekti ka si qëllim kryesor disiplinimin e ujërave dhe stabilizimin e terrenit, këto punime janë pjesë integrale e zbatimit.

2 (dy) Karpentier

Karpentieri është i nevojshëm për realizimin e kallëpeve, strukturave ndihmëse dhe elementeve të përkohshme të mbështetjes gjatë ndërtimit të bazamenteve, themeleve dhe elementeve mbajtëse ku do të instalohen mbështetëset e tubacionit DN700. Gjithashtu ai merr pjesë në përgatitjen e skelave të punës dhe strukturave ndihmëse që nevojiten për montimin e elementeve metalike në terren.

*Për shkak të punimeve të betonit dhe vendosjes së elementeve mbajtëse të parashikuara në preventiv, prania e të paktën **1 (një) karpentieri** është e domosdoshme për garantimin e realizimit korrekt të strukturave ndihmëse dhe elementeve të betonit ku ankorohen konstruksionet metalike.*

2 (dy) Saldatorë

Saldatorët janë specialistët kryesorë për realizimin e proceseve të saldimit të elementeve metalike të parashikuara në preventiv, si: mbështetëset e traut; mbështetëset e tubit; kapëset e çelikut; elementet e lidhjes së xhuntove të deformimit; pjesët metalike të sistemit mbajtës të tubacionit DN700.

Saldimi përbën një proces kritik në fabrikimin dhe montimin e strukturave metalike, pasi cilësia e saldimeve ndikon drejtpërdrejt në rezistencën, stabilitetin dhe sigurinë e elementeve mbajtëse. Strukturat metalike dhe suportet e tubacioneve realizohen përmes proceseve të prerjes, montimit dhe saldimit të komponentëve metalikë.

*Për shkak të volumit të elementeve metalike që duhet të fabrikohen dhe montohen, kërkesa për **2 (dy) saldatorë** është proporcionale dhe e nevojshme për realizimin e punimeve brenda afateve të kontratës.*

2 (dy) Punonjës Konstruksione Metalike

Punonjësit e konstruksioneve metalike janë të nevojshëm për: matjen dhe prerjen e profileve metalike; përgatitjen e elementeve për saldim; montimin e mbështetëseve të tubit dhe traut; instalimin e kapëseve të çelikut; vendosjen dhe fiksimin e elementeve metalike në pozicionin e projektuar; asistimin gjatë ngritjes dhe montimit të konstruksioneve metalike.

Fabrikimi i strukturave metalike përfshin prerjen, formimin, montimin dhe bashkimin e komponentëve metalikë sipas vizatimeve teknike, procese të cilat kryhen nga punonjës të specializuar të konstruksioneve metalike.

Hidraulikë (2)

Kërkohen për shkak të punimeve që përfshijnë: montimin e tubacionit DN700; lidhjen e elementeve të drenazhimit; vendosjen e sistemeve të kullimit; pusetat dhe elementet hidraulike të projektit.

Për shkak të volumit të konsiderueshëm të punimeve hidroteknike, kërkohen minimalisht dy specialistë.

Betonues (5)

Kërkohen për shkak të sasive të konsiderueshme të betonit të parashikuara në: pilota Ø800 mm; trarë lidhës; puseta; elemente betonarme dhe struktura ndihmëse.

Duke qenë se betonimet përbëjnë një nga proceset kryesore të objektit, kërkohet një ekip i dedikuar betonuesish.

Punëtorë të thjeshtë ndertimi (7)

Kërkohen për mbështetjen e të gjitha proceseve të punës, konkretisht: sistemimin e materialeve; ndihmën gjatë gërmimeve; asistencën në betonime; ngarkim-shkarkimin e materialeve; pastrimin dhe organizimin e kantierit.

Punëtorët e krahut janë të nevojshëm për realizimin e punimeve ndihmëse që shoqërojnë të gjitha zërat kryesorë të preventivit.

Shoferë me kategori C/CE/D/DE (3)

Kërkohen për operimin e mjeteve të parashikuara në DST dhe të nevojshme për realizimin e punimeve, si: kamionë vetëshkarkues për transport dherash dhe inertesh; kamionë për furnizim me materiale ndërtimi; mjete të transportit të pajisjeve dhe makinerive.

Preventivi përmban volume të konsiderueshme gjurmimi, largim materiale dhe furnizim me beton, armaturë, tubacione dhe materiale të tjera ndërtimore, çka e bën të domosdoshëm disponimin e shoferëve të pajisur me lejet përkatëse të drejtimit.

*Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, kërkesa për disponimin e **4 (kater) Manovratorëve / Eskavatoristëve / Automakinistëve** është vendosur në funksion të realizimit të punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat kërkojnë përdorimin e vazhdueshëm të makinerive të rënda dhe mjeteve teknologjike gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.*

Objekti i prokurimit konsiston në stabilizimin e një zone rrëshqitjeje dhe përfshin punime të konsiderueshme gjurmimi, shpimi, drenazhimi, transporti materiale dhe sistemimi terreni, të cilat realizohen kryesisht nëpërmjet mjeteve mekanike.

Nga analiza e preventivit rezulton se janë parashikuar ndër të tjera: gjurmime për hapjen e platformave të punës; gjurmime për realizimin e pilotave Ø800 mm; gjurmime për drenazhime horizontale dhe vertikale; gjurmime për vendosjen e tubacionit DN700; ngarkim dhe transport i materialeve të gjërmuara; sistemim dhe modelim i skarpave; lëvizje dhe shpërndarje materiale ndërtimore në kantier; punime rehabilitimi dhe formësimi të terrenit.

Për realizimin e këtyre proceseve kërkohet operimi i njëkohshëm i makinerive të parashikuara në dokumentet e tenderit, si: ekskavatorë me zinxhir; ekskavatorë me goma; miniekskavatorë; fadroma/ngarkues; mjete të tjera teknologjike të nevojshme për lëvizjen dhe sistemimin e materialeve.

Duke qenë se punimet zhvillohen në disa fronte pune paralelisht, operatori ekonomik duhet të disponojë personel të kualifikuar për drejtimin e secilës makineri. Çdo ekskavator, fadromë apo automakinë teknologjike kërkon manovrator të dedikuar, të pajisur me dëshmitë përkatëse profesionale, në mënyrë që të garantohet realizimi i sigurt dhe efikas i punimeve.

*Numri prej **4 (kater) manovratorësh/eskavatoristësh/automakinistësh** është përllogaritur në raport me numrin e makinerive të kërkuara për zbatimin e kontratës dhe me nevojën për operimin e tyre të njëkohshëm në:*

- 1. Frontin e gjurmimeve për pilotat;*
- 2. Frontin e drenazhimeve;*
- 3. Frontin e vendosjes së tubacionit DN700;*
- 4. Frontin e sistemimit të skarpave;*
- 5. Frontin e ngarkim-shkarkimit dhe lëvizjes së materialeve në kantier.*

Për më tepër, natyra e objektit, e lidhur me një zonë me rrëshqitje aktive dhe terren me vështirësi gjeoteknike, kërkon përdorimin e operatorëve me eksperiencë në drejtimin e makinerive të rënda, për të garantuar sigurinë e punimeve dhe respektimin e parametrave teknikë të projektit.

g) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (në rast se është inxhinier), dëshmi / certifikatë trajnimit të lëshuara nga

subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të çertifikuar me dëshmi trajnimi si “Person i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë” të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkesë kjo në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, secili prej operatorëve ekonomike duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1(një) “Person të ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit.
 - 1 (një) inxhinier duhet të jete i pajisur me Certifikaten për Vlerësimin në Mjedis.
- h) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr.742 datë 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit.**

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Agumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si **përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash** dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikqyrjes.

Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si kërkesë të kapacitetit teknik disponimin e personelit mbështetës të specializuar dhe të certifikuar, me qëllim garantimin e realizimit të kontratës në përputhje me projektin, standardet teknike, kërkesat e sigurisë në punë dhe legjislacionin sektorial në fuqi.

Objekti i kontratës përfshin punime të ndërtimit të rrjetit shpërndarës të ujësjellësit, rehabilitim të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza, gjurmime në tokë dhe shkëmb, punime betoni e

betonarmeje, montim tubacionesh dhe pajisjesh hidromekanike, punime saldimi, instalime elektrike, hidroizolime, punime metalike dhe rikonstruksion të infrastrukturës së dëmtuar. Për shkak të natyrës së këtyre punimeve dhe afatit të realizimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor vlerëson të domosdoshme disponimin e personelit të mëposhtëm:

1. Person i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë

Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr.10327, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", si dhe në VKM nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier". Duke qenë se objekti përfshin punime gërmimi, punime në thellësi, operim makinerish të rënda, ngritje dhe montim elementësh të ndryshëm ndërtimorë dhe hidromekanikë, ekziston rrezik i shtuar për sigurinë e punonjësve. Për këtë arsye është e domosdoshme prania e një personi të trajnuar dhe të certifikuar për sigurinë dhe shëndetin në punë, i cili do të monitorojë zbatimin e masave të sigurisë në kantier gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës.

Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, kërkesa që secili anëtar të disponojë person përgjegjës për sigurinë në raport me punimet që merr përsipër të realizojë mbështetet në nenin 88 të VKM nr.285/2021, pasi secili operator mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë për sigurinë e personelit të angazhuar në pjesën e kontratës që do të ekzekutojë.

Në preventiv janë parashikuar punime të konsiderueshme që ndërhyjnë drejtpërdrejt në mjedis, si: gërmime dhe sisteme toke; punime për stabilizimin e zonës së rrëshqitjes; ndërtim i strukturave mbajtëse dhe elementëve të betonit; vendosja e linjës kryesore të ujësjellësit DN700; transport dhe depozitim materiale; rikonstruksion dhe rehabilitim i terrenit pas ndërhyrjeve.

Këto punime zhvillohen në një zonë të prekur nga fenomeni i rrëshqitjes së tokës dhe pranë infrastrukturës së furnizimit me ujë, çka kërkon monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të ndikimeve në mjedis gjatë zbatimit të kontratës.

Për këtë arsye, prania e të paktën **1 (një) inxhinieri të pajisur me Certifikatë për Vlerësimin në Mjedis** është e nevojshme për: Identifikimin dhe minimizimin e ndikimeve mjedisore që mund të shkaktohen nga gërmimet, lëvizja e dherave dhe punimet ndërtimore. Monitorimin e zbatimit të masave mjedisore të parashikuara në projekt dhe në legjislacionin mjedisor. Menaxhimin e materialeve të dala nga gërmimet, mbetjeve inerte dhe transportit të tyre në përputhje me kërkesat ligjore. Parandalimin e ndotjes së burimeve ujore dhe tokës, duke qenë se objekti lidhet me infrastrukturën e furnizimit me ujë të qytetit të Beratit. Garantimin e respektimit të kushteve të lejeve mjedisore, në rast se projekti ose aktivitetet e tij janë subjekt i tyre.

Kërkesa për disponimin **e mjekut të shoqërisë** ose mjekut të kontraktuar me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë është e bazuar në Ligjin nr. 10237/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr. 742, datë 06.11.2003, si dhe lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve të ndërtimit, volumin e punimeve të parashikuara në preventiv, përdorimin e makinerive të rënda, punimet në zona me risk gjeoteknik dhe numrin e konsiderueshëm të punonjësve të angazhuar në zbatimin e kontratës. Për rrjedhojë, kjo kërkesë është proporcionale, e nevojshme dhe në funksion të garantimit të sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë realizimit të objektit të prokurimit.

2.3.4 Makineri Pajisje

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

Nr.	Përshkrimi	Sasia
1.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 ton	1 (nje) cope
2.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 5 - 10 ton	1 (nje) cope
3.	Kamionçina me kapacitet mbajtes 3.5 - 5 ton	2 (dy) cope
4.	Eskavator me zinxhire 0.5	2 (dy) cope
5.	Eskavatore me goma	1 (nje) cope
6.	Fadrome	1 (nje)cope
7.	Miniseskavator	1 (nje)cope
8.	Vinc eskavator	1 (nje) cope
9.	Vinc kulle 6 - 10 ton	1 (nje) cope
10.	Autobetoniere	2 (dy) cope
11.	Pompe betoni	1 (nje) cope
12.	Autobot Uji	2 (dy) cope
13.	Matrapik	1(nje) copë
14.	Vibrator betoni	3 (tre) copë
15.	Sonde shpimi minimumi d= 800mm	1 (nje) copë
16.	Gjenerator	2 (dy) cope
17.	Depozita uji	1 (nje) cope
18.	Pompe uji	2 (dy) cope
19.	Tokmak elektrik	2 (dy) cope
20.	Rrul ngjeshes	1 (nje) cope
21.	Grejder	1 (nje) cope
22.	Elektrosaldatrice	1 (nje) cope

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”, si më poshtë vijon:

- Kokore + Jelekë fosforoshentë minimumi 45 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 10 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

- ❖ Kriteri konsiderohet i përmbushur me *plotësimin e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8*. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin, si më poshtë:

Për mjetet që shënohen në rregjistra publikë duhet të paraqitet dokument që vërteton pronësinë e mjetit (certifikatë pronësie), dokument që vërteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS si dhe siguracionin e mjetit (policë sigurimi); të vlefshme.

Për mjetet e siguruar me qera, të paraqiten dokumentet që vërtetojnë rregjistrimin e tij, plus certifikatën e kontrollit teknik (SGS) dhe siguracionin e mjetit të vlefshme. Këto dokumente duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerasë të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Për mjetet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të paraqitet kontratë noteriale e blerjes / faturë tatimore / dokument zhdoganimi të mjetit.

Për pajisjet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi), të vlefshme.

Për pajisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt shoqëruar me akt pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi), të vlefshme.

Shënim: Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë të nënshkruar nga Administratori, me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe të pranojë verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar nga Administratori, me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik¹" në të cilin përcaktohet: *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Në nenin 39 "Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike" pika 6 /d të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 *te ndryshuar parashikohet: "Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën."*

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj kerkohet që operatorët ekonomike t'i disponojnë ato pasi nevojiten për kryerjen e

punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve /makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, kjo njesi është bazuar tek zërat dhe volumet e preventivit dhe specifikimet teknike të hartuara nga Projektuesi. Mjetet e kërkuara përkohë me proceset ndërtimore sipas zërave të preventivit dhe janë përcaktuar në varesi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të veprës.

Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar, Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshme paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit në lidhje me mjetet e pajisjet teknike që operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar mjetet dhe makineritë e mëposhtme duke u bazuar në zërat konkretë të preventivit, volumin e punimeve dhe afatin 12-mujor të realizimit të kontratës, në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 39 të VKM nr.285/2021.

Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar mjetet dhe makineritë e nevojshme për realizimin e kontratës, duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve, volumin e tyre, shtrirjen lineare të objektit dhe afatin 12-mujor të zbatimit.

Nga preventivi i punimeve rezulton se objekti përfshin gërmime në tokë dhe shkëmb, transport materialeve dhe inertesh, ndërtim pusetash, betonime, montim tubacionesh të ujësjellësit dhe kanalizimeve, vendosje të elementeve hidromekanike, rikthim të shtresave rrugore, asfaltime dhe punime ndihmëse të specializuara.

Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, makineritë e kërkuara janë përcaktuar duke analizuar metodologjinë e zbatimit të punimeve, volumin e preventivit, numrin e fronteve të punës dhe stafin teknik e specialist të kërkuar për realizimin e objektit.

Objekti përfshin: gërmime të konsiderueshme; shpime dhe realizim pilotash Ø800 mm; armim dhe betonim pilotash; drenazhime dhe vendosje tubacioni DN700; transport të materialeve; sistemim të skarpave; rehabilitim mjedisor dhe gjelbërim.

Për realizimin e këtyre proceseve kërkohet funksionimi paralel i makinerive të mëposhtme.

Kamion vetëshkarkues ≥ 20 ton (1 copë)

Keto mjete do të jenë në funksion telargimit të materialit të gërmuar; transportin e dherave dhe inerteve; transportin e aggregateve për beton; furnizimin me materiale mbushëse.

Volumi i gërmimeve për pilotat, drenazhimet dhe sistemimin e terrenit kërkon kapacitet të lartë transporti.

Kamion vetëshkarkues 5–10 ton (1 copë)

Do te përdoret për: furnizime lokale; transport të materialeve në zona me akses më të kufizuar; mbështetje logjistike të kantierit.

Kamionçina 3.5–5 ton (2 copë)

Do te përdoret për transport të personelit teknik; transport të pajisjeve të vogla; transport të materialeve ndihmëse.

Mbështet aktivitetin e inxhinierëve, teknikëve dhe specialistëve në terren.

Eskavator me zinxhir 0.5 m³ (2 copë)

Makineria kryesore e gërmimeve

Lidhet me: gërmime për pilotat Ø800 mm; gërmime për drenazhime; formim platformash pune; sistemim skarpatah.

Për shkak të volumit të konsiderueshëm të gërmimeve dhe nevojës për zhvillimin paralel të punimeve kërkohen dy ekskavatorë.

6Eskavator me goma (1 copë)

Përdoret për: gërmime në zona me lëvizshmëri më të madhe; punime pranë tubacioneve; punime drenazhimi.

Fadromë (1 copë)

Përdoret për: ngarkim inertesh; sistemim materialesh; mbushje dhe nivelime. Lidhet drejtpërdrejt me zërat e mbushjeve dhe sistemit të terrenit

Minieskavator (1 copë)

Përdoret për: punime në zona të ngushta; hapje kanalesh drenazhimi; ndërhyrje pranë tubacioneve.

Makineri e domosdoshme në zona ku ekskavatorët e mëdhenj nuk mund të operojnë.

*Bazuar në natyrën e punimeve të preventivit, kërkesa për **1 (një) Vinc Eskavator** është e argumentuar teknikisht dhe lidhet drejtpërdrejt me zërat që parashikojnë transportimin, ngritjen, pozicionimin dhe montimin e elementeve të rënda metalike dhe të tubacionit DN700.*

Konkretisht, në preventiv janë parashikuar: F.V Tubi DN 700 mm; F.V Xhunto deformimi trau; F.V Xhunto deformimi tubi; F.V Mbështetëset e traut; F.V Mbështetëset e tubit; F.V Kapëse çeliku.

Këto elemente kanë përmasa dhe peshë të konsiderueshme dhe kërkojnë pajisje ngritëse për t'u transportuar, manovruar dhe vendosur me saktësi në pozicionin e projektuar. Eskavatorët e pajisur me sistem ngritjeje (vinc) përdoren gjerësisht në projektet infrastrukturore për ngritjen dhe vendosjen e tubacioneve, elementeve metalike, mbështetëseve dhe materialeve të ndërtimit në zona me akses të kufizuar.

Në këtë objekt, Vinc Eskavatori është i nevojshëm për: ngritjen dhe vendosjen e segmenteve të tubacionit DN700; shkarkimin dhe lëvizjen e materialeve të rënda në kantier; montimin e

mbështetëseve metalike të tubit dhe traut; vendosjen e kapëseve dhe elementeve të fiksimit; asistimin gjatë instalimit të xhuntove të deformimit; kryerjen e manovrave në terrene të vështira dhe në zonën e rrëshqitjes ku përdorimi i autovinçit mund të jetë i kufizuar.

Duke qenë se objekti lidhet me mbrojtjen dhe rivendosjen e funksionalitetit të linjës kryesore të furnizimit me ujë DN700 në një zonë rrëshqitjeje, kërkohet që elementet e tubacionit dhe konstruktionet mbajtëse të pozicionohen me saktësi dhe siguri. Për këtë arsye, Vinc Eskavatori shërben si mjet teknologjik për ngritjen dhe montimin e këtyre elementeve, duke reduktuar rrezikun gjatë punimeve dhe duke garantuar realizimin e tyre sipas projektit.

Vinc kulle 6 - 10 ton (1 copë)

Vinci Kulle lidhet drejteperdrejte me zerrat e preventivit , konkretisht Analiza 2.166 dhe 3.288 që kanë të bëjnë me punimet e armaturave te hekurit periodik .

Autobetonierë (2 copë)

Preventivi përmban: betonimin e pilotave Ø800 mm; betonimin e trarëve lidhës; betonimin e pusetave. Volumi i betonit kërkon furnizim të vazhdueshëm gjatë hedhjes së betonit.

Pompë betoni (1 copë)

Përdoret për: betonimin e pilotave në thellësi; hedhjen e betonit në elementët strukturorë. Ky është një element teknik thelbësor për realizimin e pilotave Ø800 mm.

Autobot uji (2 copë)

Përdoret për: kontrollin e pluhurave; furnizimin me ujë të kantierit; lagjen e sipërfaqeve të mbjella; ndihmë në betonime.

Matrapik (1 copë)

Përdoret për: prishje elementësh ekzistues; thyerje materialesh të forta; pastrim të zonave të gërmimit.

Vibrator betoni (3 copë)

Përdoret për: kompaktimin e betonit në pilota; kompaktimin e trarëve; kompaktimin e pusetave.

Numri prej 3 copësh justifikohet nga nevoja për betonime të vazhdueshme dhe frontet e ndryshme të punës.

Sonde shpimi minimum Ø800 mm (1 copë)

Makineria kryesore e objektit

Lidhet drejtpërdrejt me: realizimin e pilotave Ø800 mm. Pilota është elementi kryesor stabilizues i projektit.

Gjenerator (2 copë)

Përdoret për: furnizimin me energji të pajisjeve; funksionimin e sondës; funksionimin e pompave dhe pajisjeve elektrike.

Duke qenë se punimet kryhen në terren të hapur, burimi alternativ i energjisë është i domosdoshëm.

Depozitë uji (1 copë)

Përdoret për: rezervë ujore për betonime; furnizim të autoboteve; rehabilitim mjedisor.

Pompa uji (2 copë)

Përdoret për: largimin e ujërave nga gjurmimet; mbajtjen e fronteve të punës të thata; drenimin gjatë realizimit të pilotave.

Tokmak elektrik (2 copë)

Përdoret për: ngjeshjen e mbushjeve pranë tubacioneve; ngjeshjen e kanaleve të drenazhimit; punime lokale ku rruli nuk mund të operojë.

Rrul ngjeshes (1 copë)

Përdoret për: ngjeshjen e shtresave të mbushjes; stabilizimin e platformave të punës; sistemimin përfundimtar të terrenit.

Numri i tyre është përcaktuar në raport me volumin e punimeve, zhvillimin paralel të disa fronteve pune dhe stafin teknik të kërkuar (inxhinierë, teknikë, specialist sonde, manovratorë, betonues, hidraulikë, muratorë, hekurkthyes etj.), duke garantuar kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës sipas afateve dhe specifikimeve teknike.

Kërkesa për 1 (një) Grejder lidhet drejtpërdrejt me punimet e gjurmimit, sistemimit dhe profilizimit të terrenit në zonën e rrëshqitjes ku do të realizohet mbrojtja e linjës kryesore DN700. Grejderi është mjeti kryesor për nivelimin dhe profilizimin me saktësi të sipërfaqeve, krijimin e pjerrësive sipas projektit dhe sistemimin e shtresave të tokës pas punimeve të gjurmimit dhe mbushjes.

Në objektin konkret, grejderi është i nevojshëm për: profilizimin e terrenit në zonën e rrëshqitjes; sistemimin e platformave të punës ku do të montohen mbështetëset e tubacionit; formimin e pjerrësive për largimin e ujërave sipërfaqësore; nivelimin e mbushjeve pas vendosjes së tubacionit dhe elementeve mbështetëse; krijimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të përkohshme të aksesit në kantier.

Duke qenë se objekti zhvillohet në një terren me problematikë gjeologjike dhe rrëshqitje, profilizimi korrekt i sipërfaqeve dhe kontrolli i drenazhimit përbëjnë elemente thelbësore për stabilitetin afatgjatë të veprës. Për këtë arsye disponimi i një grejderi konsiderohet proporcional dhe i lidhur me realizimin e punimeve të preventivit.

Kërkesa për 1 (një) Elektrosaldatrice lidhet drejtpërdrejt me zërat e preventivit që parashikojnë furnizimin dhe montimin e elementeve metalike të sistemit mbajtës të tubacionit DN700, konkretisht: F.V Mbështetëset e traut; F.V Mbështetëset e tubit; F.V Kapëse çeliku; F.V Xhunto deformimi trau; F.V Xhunto deformimi tubi; elementët metalikë ndihmës të montimit të tubacionit DN700.

*Procesi i montimit të këtyre elementeve kërkon realizimin e saldimeve në kantier ose fabrikimin paraprak të pjesëve metalike që më pas instalohen në objekt. Elektrosaldatricja është pajisja bazë teknologjike që mundëson bashkimin e profileve metalike, pllakave lidhëse, kapëseve, mbajtëseve dhe elementeve të ankorimit që garantojnë qëndrueshmërinë e tubacionit. Kjo lidhet drejtpërdrejt edhe me kërkesën për saldatorë dhe me certifikimin **ISO 3834-2:2021**, i cili rregullon sistemin e cilësisë në proceset e saldimit.*

Përmes elektrosaldatricës realizohen: saldimi i mbështetëseve metalike të tubit; saldimi i kapëseve dhe elementeve të fiksimit; bashkimi i profileve metalike të strukturave mbajtëse; riparimet dhe përforcimet metalike gjatë montimit në terren; punimet ndihmëse të nevojshme për instalimin e elementeve të çelikut.

2.3.5. Afati i kryerjes së punimeve

Afati i kryerjes së punimeve është 8 muaj e 20 ditë (tete muaj e njetete dite) muaj sipas Grafikut të Punimeve të publikuar ne SPE

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

2.3.6. Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakort me menyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të perfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, (Në rast të shpalljes fitues).

Në funksion të plotësimit të Shtojcës Nr. 8

“Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Atësi, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numër Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin / Administratorët e shoqërise, Ortakun / Ortakët e shoqërise, përfaqësues të ndryshëm të posacëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Bazuar në parashikimet e Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet: *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin;*

Si dhe sipas Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 neni 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Pika 5 ku parashikohet: *“Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:*

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1 të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s`kualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike: Bazuar në specifikimet teknike dërguar nga shoqëria projektuese dhe përcjelle për punimet e vepres, duke qenë se specifikimet teknike të përcjella, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 40 pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, njësia e prokurimit po publikon specifikimet teknike.

Njesia e Prokurimit